

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6927  
E mërkurë, 21 qershor 2023  
Çmimi 0.40 €

Enver Hasani: Asnjë marrëveshje nuk lejon formimin e njëanshëm të Asociacionit FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ZYRTARI I LARTË AMERIKAN, GABRIEL ESCOBAR, DHE AI I BE-së, MIROSLAV LAJÇAK, KANË FOLUR SËRISH PËR SITUATËN NË VERI FAQE 4-5

## ESCOBARI PËRMEND KONFLIKT RAJONAL, LAJÇAKU VIKTIMA

- "Çfarë po kërkojmë nga Kosova është koordinimi i ngushtë dhe t'i pranojë obligimet ndërkombëtare", thotë Gabriel Escobar



I dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë "potencial të shndërrohen në konflikt rajonal". Këto deklarata ai i ka bërë në

një debat të zhvilluar nga Këshilli i Atlantikut në Uashington, së bashku me të dërguarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak. Ky i fundit ka thënë se nëse nuk arrijnë ta shtensionojnë situatën do të ketë viktima. Escobari u

pyet edhe për akuzat se ShBA-ja dhe BE-ja janë të buta ndaj Serbisë dhe të ashpra me Kosovën. Por, zyrtari amerikan tha se për 15 vjet, çdo gjë që ka bërë Uashingtoni ka qenë në favor të Kosovës

KURTI: AMBASADORI JETISH JASHARI I KA VIZITUAR POLICËT, ATA JANË RRËMBYER DUKE NGRËNË DREKË FAQE 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



ADIEU ALAIN GIRESSE F. 10

IRANIANËT NË SHOIPËRI KUNDËRSHTOJNË KONTROLLET POLICORE F. 2

BAKOYANNIS EMËROHET RAPORTUESE PËR ANËTARËSIM TË KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS F. 3

HOXHAJ ME DELEGACIONIN NGA PARLAMENTI I AUSTRIËS: PROCESI POLITIK RIINTEGROKOMUNITETIN SERB DHE LARGON BANDAT NGA VERIU F. 7



BQK-ja MBËSHTET AGJENDËN E GJELBËR NË SEKTORIN FINANCIAR F. 8

PSD-ja: QEVERIA I PËRMEND PUNËTORËT VETËM PËR FUSHATË F. 8

SPORT

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Iranianët në Shqipëri kundërshtojnë kontrollet policore

**TIRANË, 20 QERSHOR** - Që në orët e para të mëngjesit të 20 qershorit, Policia e Shtetit në Shqipëri po kryen kontrolle në mjediset ku janë të strehuar rreth 3 000 pjesëtarë të opozitës iraniane, në kampin e Manzës të Durrësit. Sipas njoftimit, policia tha se kontrollet po kryhen me vendim të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe urdhër të Strukturës së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK). Zëdhënësi i iranianeve të strehuar në Shqipëri të Organizatës së Muxhahedinëve të Popullit të Iranit (MEK) tha për mediet se dy persona kanë humbur jetën gjatë përlëshjeve me policinë. Por, policia shqiptare i ka mohuar këto pretendime. Zëdhënësi i MEK-ut, po ashtu, pretendoi se disa persona janë plagosur.

Aktualisht ka përplasje mes policisë dhe banorëve në këtë kamp.

Aksioni në kampin në Manzë po kryhet në kuadër të një plani operacional, që ka nisur me kontrollin e të gjitha ambienteve dhe zyrave në kampin ku janë të vendosur pjesëtarët e MEK-ut.

Policia tha se kontrollet po kryhen duke respektuar etikën dhe komunikimin, si dhe liritë dhe të drejtat themelore të të gjithë qytetarëve dhe komunitetit që banon në këtë kamp.

Aktualisht nuk dihet nëse janë lëshuar urdhërarrestime, por autoritetet thanë se në fund të kontrolleve do të japin informacione.

Më 2013 autoritetet shqiptare janë pajtuar - me kërkesë të Shteteve të Bashkuara - që të pranojnë rreth 3 000 pjesëtarë të Organizatës së Muxhahedinëve të



Popullit të Iranit (MEK).

Irani i konsideron pjesëtarët e kësaj organizate si terroristë. Shqipëria ka ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me

Iranin, pasi e fajësoi Iranin se qëndron prapa një sulmi kibernetik që ndodhi në korrik të vitit 2022.

Ndërkaq një vit më parë u anulua,

për arsye sigurie nga kërcënime terroriste, Samiti Botëror i Iranit të Lirë, që do të mbahej më 23 dhe 24 korrik në "Ashraf 3" në Manzë të Durrësit.

## Ukraina raportohet se ka përmbushur disa nga kushtet për bisedimet me BE-në

**KIEV, 20 QERSHOR** - Në raportin e Bashkimit Evropian, që do të publikohet këtë javë, do të thuhet se Ukraina ka përmbushur dy nga shtatë kushtet për t'i nisur negociatat e anëtarësimit, thanë për "Reuters" dy burime në BE. Komisioni Evropian - trupi ekzekutiv i bllokut evropian - pritet ta theksojë përparimin e arritur pavarësisht prej pushtimit të nisur nga Rusia.

Në një lëvizje shumë simbolike, BE-ja vitin e kaluar i dha Ukrainës statusin e vendit kandidat, vetëm katër muaj pasi Rusia nisi luftën ndaj Kievit, që po përpqet të integrohet me Perëndimin.

Por, BE-ja i vendosi shtatë kushte - përfshirë edhe reformat në gjyqësor dhe uljen e korrupsionit endemik për ta nisur procesin e negociatave për anëtarësim.



Ukraina ka bërë thirrje që bisedimet të nisin gjatë këtij viti, transmeton "REL".

Raporti i Komisionit Evropian po vlerësohet si arritje e madhe në këtë proces, teksa mbështetësit e Ukrainës po kërkojnë që asaj t'i mundësohet një pranim i shpejtë

dhe nga 27 shtetet anëtare në dhjetor të merret vendim për nisjen e bisedimeve me Kievin.

Dy zyrtarë të lartë të BE-së, që kanë njohuri për këtë raport i cili ende nuk është bërë publik, i thanë "Reuters"-it se Ukraina deri më tani ka plotësuar dy kritere. Sipas

zyrtarëve, këto kritere lidhen me reformat në gjyqësor dhe ligjin për mediet, duke shtuar se raporti është pozitiv për Kievin. "Ka përparim. Raporti do të jetë mesatarisht pozitiv", tha zyrtari që foli në kushte anonimiteti. "Nuk ka të bëjë me zbulim të realitetit, por me njohjen e përparimit. Për shembull, ka pasur raste të mëdha kundër korrupsionit".

Muajt e fundit Ukraina ka ndjekur disa raste të profilit të lartë kundër korrupsionit, përfshirë këtu edhe arrestimin e kreut të Gjykatës Supreme nën dyshimet për ryshfet prej 2.7 milionë dollarësh.

Kriteri tjetër i përmbushur ka të bëjë me reformat në Gjykatën Kushtetuese të Ukrainës dhe në forcat ligjzbatuese, për masat kundër pastrimit të parave, por edhe miratimit të ligjeve për t'i

penguar oligarkët dhe për t'i mbrojtur të drejtat e pakicave kombëtare.

Raporti, që është një përditësim i përkohshëm para vlerësimit final që do të bëhet në tetor, do të dorëzohet te të dërguarit e 27 shteteve anëtare të mërkurën, dhe te ministrat e Jashtëm gjatë takimit të tyre të enjten.

Të 27 shtetet e BE-së vendosin nëse do të nisin ose jo bisedimet për anëtarësim të Kievit.

Për t'i nisur bisedimet, Ukraina duhet t'i përshatë ligjet dhe standardet e BE-së në shumë fusha. Në praktikë, rruga e Ukrainës drejt anëtarësimit mund të marrë disa vjet, por shumë pak besojnë se ky shtet mund t'i bashkohet bllokut evropian gjatë kohës kur lufta me Rusinë po vazhdon.

## Aktakuza kundër Trumpit krijon ndarje mes disa republikanëve

**UASHINGTON, 20 QERSHOR** - Edhe pse ish-presidenti Donald Trump u deklarua "i pafajshëm" javën e kaluar ndaj akuzave për mbajtje të qëllim të të paautorizuar të dokumenteve sekrete, aktakuza e fundit ndaj tij vazhdon të nxisë debate të nxehta mes anëtarëve të partisë republikane.

Kandidati republikan për president dhe ish-prokurori Asa Hutchinson tha se Trumpi duhet të tërhiqet nga gara presidenciale. "Kur ke mbi vete sfidën e hetimeve të shumta gjatë rrjedhës së vitit të ardhshëm nuk është e drejtë për vendin, dhe sigurisht

nuk është e drejtë për partinë tonë që dëshiron ta kthejë këtë vend në rrugën e duhur", tha ai.

I intervistuar nga kanali NBC, ish-nënpresidenti Mike Pence, i cili gjithashtu kandidon për president, pyeti përse konkurrentët në zgjedhjet paraprake republikane supozojnë se Trumpi do të shpallet fajtor. "Gjithçka që dimë është se për çfarë është akuzuar presidenti në aktakuzë. Nuk e dimë cilat janë argumentet e mbrojtjes së tij. Nuk e dimë nëse kjo çështje do të shkojë në gjyq. Aktakuzat mund të deklarohet e pavlefshme", ka

thënë Pence.

Duke dalë në kanalën CNN, kryetari i Komisionit të Inteligjencës në Dhomën e Përfaqësuesve, republikani Mike Turner, nënvizoi rëndësinë e zhvillimit të procesit ligjor. "Sigurisht që nuk do ta mbroj sjelljen që është parashtruar në atë aktakuzë, por ata do të duhet ta provojnë atë".

Presidenti Joe Biden, i cili filloi fushatën për rizgjedhje këtë fundjavë, ka refuzuar t'i komentojë sfidat ligjore të Trumpit. Bideni po u bindet rregullave që mbrojnë hetimin.



# Kurti: Ambasadori Jetish Jashari i ka vizituar policët, ata janë rrëmbyer duke ngrënë drekë

Kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, të martën kanë mbajtur konferencë për medie në lidhje me rrëmbimin e tre policëve të Kosovës

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kryeministri Albin Kurti, në një konferencë për medie mbajtur të martën, ka treguar se shefi i Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës në Serbi, Jetish Jashari, i ka vizituar tre policët e rrëmbyer. Ai ka thënë se policët i kanë rrëfyer Jetishit momentin e rrëmbimit nga njësitë serbe. "Të tre kanë qenë bashkë. Të tre e kanë rrëfimin e njëjtë kur pyeten ndaras nga njëri-tjetri nga ambasadori ynë. Përshkrimi i policëve është i njëjtë. Janë tri rrëfime të ndara identike, të cilët thonë se në momentin e rrëmbimit, më 14 qershor, kanë qenë te tryeza e improvizuar për ngrënie. Pra kanë qenë duke ngrënë drekë kur 15 persona i kanë rrethuar, sulmuar dhe rrëmbyer", ka thënë ai.

Kurti ka thënë se kjo heq çfarëdo dileme edhe për ata që "dëshirojnë të jenë skeptikë". "Dëshmitë që posedojnë institucionet tona dhe dëshmia e

tre policëve dëshmojnë qartë që ishin brenda territorit", ka thënë Kurti.

Ai ka bërë thirrje që të lirohen sa më shpejt të tre policët e Kosovës. Kurti ka thënë se kjo është hakmarrje nga ana e Serbisë për arrestimin e kapos së "Mbrojtjes Civile", Milun Milenković-Llune. "Serbia përdori instrumentin më qyqar, atë të rrëmbimit të tre zyrtarëve policorë. Për hakmarrje ç'njerëzore kemi kërkuar denoncim të hapur nga të gjithë partnerët tanë", ka deklaruar Kurti. Sipas Kurtit, Serbia "me këto akte agresioni" synon destabilizim në Kosovë.

Gjatë konferencës Gërvalla ka thënë se ambasadori Jashari i ka vizituar të burgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Kraljevë. Ajo ka thënë se takimet janë mbajtur ndaras, nga 15 minuta me secilin. "Aty secili prej zyrtarëve policorë e ka përshkruar ngjarjen e rrëmbimit të tyre, që nga momenti i kapjes, deri te dalja



para prokurorit dhe gjyqtari i procedurës paraprake", ka thënë Gërvalla. Ajo ka thënë se policët kanë deklaruar se nuk janë maltretuar, por nuk u janë dhënë shumë ushqim dhe njërit prej

tyre i mungojnë ilaçet e nevojshme për sëmundjet kronike nga të cilat vuan.

Zyrtarët policorë të Kosovës janë arrestuar nga autoritetet serbe më 14 qershor.

Prishtina ka thënë se ata janë rrëmbyer në territorin e Kosovës, ndërsa Beogradi ka thënë se ata janë arrestuar në territorin serb. Faktori ndërkombëtar ka bërë thirrje për lirimin e tyre pa kushte.

## Enver Hasani: Asnjë marrëveshje nuk lejon formimin e njëanshëm të Asociacionit

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Profesi i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Enver Hasani, ka thënë se asnjë marrëveshje nuk lejon formimin e njëanshëm të Asociacionit. Por, sipas tij, e sigurt është se pa një dekret nga ana e Qeverisë së Kosovës, Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe nuk mund të formohet, madje as në mënyrë të njëanshme. "Statuti, i cili është akti themel i Asociacionit ose struktura normative më e lartë brenda tij, merr jetë ose frymë me një vendim të qeverisë, pastaj shkon në Gjykatë Kushtetuese për t'u konfirmuar nëse është në pajtim me Kushtetutën. Kjo procedurë figuron në të gjitha marrëveshjet - edhe në atë të fundit në Ohër, në atë të Brukselit të vitit 2013 dhe atë 2015-s, nuk ka alternativë tjetër", thotë Hasani, raporton "Radio Evropa e Lirë".

Ai shton se strukturat që e përbëjnë Asociacionin nuk mund të formohen pa marrë fuqi



juridike statuti. Fuqia juridike e statutit të Asociacionit, siç thotë Hasani, mund të sigurohet vetëm me një akt të qeverisë dhe me "lejen" nga Gjykata Kushtetuese, "e cila do të nënkuptonte se

statuti dhe akti, me të cilin ai hyn në fuqi, nuk janë kundërkushtetuese". Në të kundërtën, siç thotë profesor Hasani, në rast se serbët e shpallin njëanshëm formimin e

Asociacionit, kriza do të thellohej edhe më tej. "Pastaj nuk bëhet më fjalë për strukturë normative vetorganizuese, por bëhet fjalë për prodhim të një krize e cila e ka një dimension tjetër prej kësaj që

e shohim sot dhe me të cilën duhet të merret Brukseli (BE-ja, si ndërmjetësuese e dialogut Kosovë - Serbi) dhe palët", ka theksuar Hasani, duke shtuar se, megjithatë, nuk beson që pala serbe do të hyjë, siç e quan ai, në "një aventurë të tillë".

Zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialogun Kosovë - Serbi, përfshirë edhe formimin e Asociacionit, e parasheh edhe marrëveshja e fundit drejt normalizimit të marrëdhënieve mes palëve, e arritur më 27 shkurt në Bruksel, si dhe pajtimi për aneksin e zbatimit të saj, që u arrit më 18 mars në Ohër.

Bashkimi Evropian i ka ftuar Kurtin dhe Vuçiçin për një takim në Bruksel gjatë kësaj jave në mes të tensioneve të rritura mes dy shteteve. Presidenti i Serbisë tashmë ka deklaruar se refuzon të takohet me Kurtin, ndërsa ky i fundit ende nuk ka vendosur nëse do të marrë pjesë në takimin e Brukselit.

## Bakoyannis emërohet raportuese për anëtarësim të Kosovës në Këshillin e Evropës

Prishtinë, 20 qershor - Ish-ministrja e Punëve të Jashtme e Greqisë, Dora Bakoyannis, është caktuar të martën raportuese për anëtarësim të Kosovës në Këshillin e Evropës. Ajo është

zgjedhur nga Komiteti për Çështje Politike dhe Demokraci në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Lajmin e kanë dhënë deputetët Ariana Musliu -

Shoshi dhe Arben Gashi. Deputetët Ariana Musliu - Shoshi, Arben Gashi dhe Besnik Tahiti janë pjesë e delegacionit të Kosovës që është duke qëndruar në Strasburg.





ZYRTARI I LARTË AMERIKAN, GABRIEL ESCOBAR, DHE AI I BE-SË, MIROSLAV LAJÇAK, KANË FOLUR SËRISH PËR SITUATËN NË VERI

# Escobari përmend konflikt rajonal, Lajçaku viktima

- “Çfarë po kërkojmë nga Kosova është koordinimi i ngushtë dhe t’i pranojë obligimet ndërkombëtare”, thotë Gabriel Escobar

I dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë “potencial të shndërrohen në konflikt rajonal”. Këto deklarata ai i ka bërë në një debat të zhvilluar nga Këshilli i Atlantikut në Uashington, së bashku me të dërguarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak. Ky i fundit ka thënë se nëse nuk arrijnë ta shtensionojnë situatën do të ketë viktimë. Escobari u pyet edhe për akuzat se ShBA-ja dhe BE-ja janë të buta ndaj Serbisë dhe të ashpra me Kosovën. Por, zyrtari amerikan tha se për 15 vjet, çdo gjë që ka bërë Uashingtoni ka qenë në favor të Kosovës

**EPOKA ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 QERSHOR - I dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë “potencial të shndërrohen në konflikt rajonal”. Këto deklarata ai i ka bërë në një debat të zhvilluar nga Këshilli i Atlantikut në Uashington, së bashku me të dërguarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak. Ndërkaq, Lajçaku tha se prioriteti i parë është shtensionimi i situatës, “t’i largojmë njerëzit nga rruga dhe t’i

kthehemi dialogut”. “Nëse nuk arrijmë ta shtensionojmë [situatën], do të kemi viktimë”, tha ai.

Sa iu përket tre policëve të Kosovës, që gjenden në paraburgim në Serbi, Escobari tha edhe nëse ata janë rrëmbyer apo kanë hyrë gabimisht në territorin serb, ata duhet të lirohen menjëherë.

Këtë qëndrim e përkrahi edhe Lajçaku.

Lajçaku ka theksuar se takimi për menaxhimin e krizave në Bruksel do të mbahet pavarësisht prej deklaratave të liderëve të Kosovës dhe të Serbisë. “Nëse do të

refuzohej do të kishte pasoja serioze dhe negative”, ka pohuar ai, duke shtuar se takimi që do të mbahet shumë shpejt do të fokusohet vetëm në menaxhimin e krizës aktuale.

Duke folur për kërkesën për zgjedhjet e reja në veri të Kosovës, Lajçaku ka theksuar se ka dy mënyra: ose përmes dorëheqjes së kryetarëve aktualë në veri të Kosovës, apo përmes referendumit. Ai tha se të dyja do t’i ndiqnin ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës. “Por, deri më tani nuk kemi parë vullnet politik për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme”, ka theksuar ai.

Escobari u pyet për akuzat se ShBA-ja dhe BE-ja janë të buta ndaj Serbisë dhe të ashpra me Kosovën. Por, zyrtari amerikan tha se për 15 vjet çdo gjë që ka bërë Uashingtoni ka qenë në favor të Kosovës, duke filluar nga pranimi i pavarësisë, fushata për njohjet e Kosovës, pranimi i zgjedhjeve të fundit në veri. “Sfidoj të gjithë të më tregojnë se kur kemi qenë të ashpër me Kosovën dhe të butë ndaj Serbisë. Çfarë po kërkojmë nga Kosova është koordinimi i ngushtë dhe t’i pranojë obligimet ndërkombëtare. Nuk mendoj se kjo mund të përkthehet se ne jemi të ashpër me Kosovën. Mendoj se është e kundërta”, ka deklaruar Escobari.

## Draft-statuti i Ramës, propozim serioz

Sa i përket themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, dy zyrtarët perëndimorë thanë se themelimi i tij është obligim

ndërkombëtar i Kosovës, që duhet të bëhet në bazë të Kushtetutës së Kosovës. “Besoj te BE-ja, te modelet evropiane. Duam që bashkërisht ta hartojmë statutin, që do të bazohet në modelet më të mira evropiane. Ne kemi analizuar 16 modele evropiane. Të sigurohemi që të krijojmë diçka që nuk është një përbindësh, por që funksionon për Kosovën dhe Serbinë”, ka pohuar Lajçaku.

Ndërkaq Escobari ka thënë se ShBA-ja përkrah një asociacion që nuk shkakton probleme në funksionimin e shtetit.

Të pyetur se cila është mënyra përpara për të dyja palët, zyrtarët perëndimorë thanë se Kosova dhe Serbia duhet t’i respektojnë obligimet e tyre të dala nga dialogu.

Escobari ka theksuar se është e rëndësishme që të ketë zbatim të marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve të arritur në shkurt në Bruksel dhe më pas Aneksi për zbatimin e saj në mars në Ohër përmes të cilit Serbia, veç të

tjerash, do t'i njihet simbolet e Kosovës dhe të drejtën e saj për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Ndërkaq, për Kosovën ai tha se është e rëndësishme që t'i nisë "menjëherë dhe urgjentisht bisedimet për themelimin e Asociacionit".

Që të dy zyrtarët e cilësuan si "propozim serioz" draft-statutin e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për Asociacionin.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë më 8 qershor se ua ka dërguar një draft për Asociacionin, presidentit të Francës, Emmanuel Macron, dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz. Rama ka thënë se dokumenti është konfidencial, por është shprehur i bindur se është "një dokument i nivelit më të lartë ndërkombëtar që merr në konsideratë të gjitha arsyet për krijimin e Asociacionit dhe që Asociacioni është pjesë e organizimit të jetës për Kosovën". Dy javë më parë Escobari dhe Lajçaku qëndruan në Kosovë dhe Serbi për t'i ndihmuar palët që t'i ulin tensionet. Ata i paraqitën kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, tri kërkesa: qetësimin e situatës në veri, mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat në veri të banuara me shumicë serbe, dhe rikthimin në dialogun për normalizimin e raporteve që ndërmjetësohet nga BE-ja.

Kurti ka paraqitur një plan prej pesë pikash, ku përfshihet edhe mundësia e mbajtjes së zgjedhjeve të reja. Tensionet në veri janë rritur që nga 26 maji. Atë ditë serbët nisën protestat kundër hyrjes në ndërtesat komunale të kryetarëve të rinj shqiptarë të Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit, të cilët hynë në ndërtesa me asistimin e Policisë së Kosovës. Që atëherë serbët lokalë kanë

protestuar në veri, duke kundërshtuar kryetarët që u zgjedhën më 23 prill - zgjedhje që u bojkotuan nga partitë dhe popullata serbe.

Më 29 maj protestat u përshkallëzuan në dhunë, me serbët që u përlëshën në Zveçan me ushtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Më 14 qershor raportet u tensionuan edhe më shumë, pasi tre policë të Kosovës u arrestuan nga forcat serbe. Kosova thotë se ata u rrëmbyen brenda territorit të saj, por Serbia thotë se i arrestoi "thellë" brenda shtetit të saj. Ndërkombëtarët kanë kërkuar lirinë e tre policëve pa kushte. Ata gjenden në paraburgim në Krallëvë të Serbisë.

Për shkak të rritjes së tensioneve, BE-ja ka ftuar një takim krize gjatë kësaj jave. Por, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka refuzuar të takohet me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Ky i fundit ka thënë se nuk do të vendosë për pjesëmarrje në takimin e Brukselit pa kuptuar gjendjen e tre policëve që po mbahen në Serbi.

### Parlamenti Evropian u bënë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i ulin tensionet

Parlamenti Evropian u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë që t'i ulin tensionet në kohën kur i gjithë kontinenti evropian po kalon nëpër një situatë të ndjeshme. Këto thirrje u bënë nga presidentja e PE-së, Roberta Metsola, gjatë vizitës në Kroaci për shënimin e 10-vjetorit të anëtarësimit të Zagrebit në Bashkimin Evropian.

Metsola ka theksuar se agresioni i Rusisë kundër Ukrainës është një dëshmi se sa kanë ndryshuar rrethanat sot në Evropë dhe me çfarë sfidash po përballet

kontinenti. "Ne si Parlament Evropian u kemi bërë thirrje Serbisë dhe Kosovës ta shtensionojnë situatën. Shtensionimi është fjala kyçe këtu. Nuk mund të shohim më shumë dhunë në kohën kur kontinenti ynë është aq i ndjeshëm", ka thënë Metsola.

Udhëheqësja e PE-së, duke iu referuar rolit të Kroacisë në rajon, tha se ky shtet mund të ndihmojë duke luajtur një rol aktiv, por edhe duke shërbyer si shembull se si zgjerimi i BE-së është një tregim suksesi. "Transformimi i Kroacisë është shembull që duhet të ndiqet nga të tjerët. Kroacia mund të luajë rol udhëheqës për t'i ndihmuar vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor jo vetëm me mbështetje politike, por edhe me përvojën që ka gjatë procesit, përmes të cilit u bë anëtare", ka theksuar Metsola, duke shtuar se: "Partnerët tanë nga Ballkani Perëndimor janë tepër gjatë në 'dhomën e pritjes' dhe kjo duhet të ndryshojë. Të dyja palët duhet të bëhen serioze dhe ky proces të lëvizë", shtoi ajo.

Edhe shefi i misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, gjenerali Angelo Michele Ristuccia, u ka bërë thirrje Prishtinës dhe Beogradit të

heqin dorë nga "retorika e kotë" dhe të bisedojnë për t'i ulur tensionet. "I ftoj sërish të dyja palët që ta shmangin retorikën e kotë dhe të përballesh me këtë sfidë në tavolinë të negociatave, pasi kjo është rruga e vetme për ta zgjidhur këtë situatë", u ka thënë ai gazetarëve në selinë e KFOR-it në Prishtinë.

### KMDLNj: Mos i keqpërdorni për qëllime politike policët e rrëmbyer të Kosovës

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) përmes një reagimi ka bërë thirrje që mos të keqpërdoren për qëllime politike policët e rrëmbyer të Kosovës. "Serbia nuk është e njohur për trajtimin e mirë të personave të privuar nga liria sepse trajtimi i tyre nuk monitorohet nga burimet e pavarura. Për rastet e të arrestuarve (më herët), shtetas të Kosovës, KMDLNj nuk ka informata se janë keqtrajtuar gjatë bisedave me ta dhe familjarët, prandaj edhe me rastin e trajtimit të tre policëve të rrëmbyer, në mungesë të informatave askush nuk mund të

thotë asgjë konkrete për keqtrajtim eventual. Se çka thotë Aleksandër Vuçiq nuk paraqet ndonjë interes për faktin se nuk është burim i pavarur i informatave. Po të donte, pa asnjë dyshim do të siguronte qasje për të vizituar policët e rrëmbyer nga ndonjë burim i pavarur në ndërkohë që KMDLNj ka shfaqur vullnet dhe gatishmëri që në çdo kohë, nëse sigurohen kushtet, t'i vizitojë policët e Kosovës", thuhet në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se institucionet e Kosovës kurrë dhe në asnjë çast nuk kanë penguar vizitat e monitoruesve apo familjarëve në raste kur shtetasit e Serbisë apo serbët e Kosovës (me shtetësi të dyfishtë) janë arrestuar në Kosovë, qoftë gjatë paraburgimit apo vuajtjes së dënimit.

Sipas KMDLNj-së, opinioni duhet ta ketë të qartë se Qeveria e Kosovës dhe asnjë institucion tjetër nga Kosova nuk ka asnjë mundësi të ketë qasje te policët e rrëmbyer, prandaj thuaja të gjitha deklaratat janë deklarata politike për përdorim të brendshëm. KMDLNj u ka bërë thirrje të gjithë aktorëve, pozitë dhe opozitë, medie dhe personave me ndikim, që të përmbahen nga deklaratat e papërgjegjshme që shkaktojnë paqartësi dhe hutitë të familjarët dhe opinioni, duke rritur shpresat dhe duke caktuar data për lirinë e policëve të rrëmbyer. "Nuk ka asnjë dyshim që Qeveria e Kosovës përmes kanaleve diplomatike angazhohet që çështja e policëve të rrëmbyer të zgjidhet sa më shpejt, por se kjo nuk është në dorën e tyre. KMDLNj shpreson se policët e rrëmbyer do të lirohen shpejt, se ata janë mirë me shëndet dhe se ndërkombëtarët e kanë në duar dinamikën e liritë të tyre për faktin se kanë kërkuar lirinë të pakushtëzuar", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

## Lirohen për qarkullim tri pikat kufitare me Serbinë

Janë liruar për qarkullim tri pikat kufitare me Serbinë, Jarinjë, Merdar dhe Bërnjak, ka njoftuar të martën Ministria e Punëve të Brendshme, saktësisht Qendra Kombëtare e Menaxhimit Kufitar sipas të dhënave të fundit të përditësuar në orën 12:58. Më herët këto pika kufitare kanë qenë të bllokuara për shkak të protestave që janë mbajtur në Serbi. Siç njofton MPB-ja, tashmë rrugët janë të lira për qarkullim dhe se dalja dhe hyrja në territorin e Kosovës bëhet nga tre deri në pesë minuta.



## Komuna e Prizrenit nënshkruan kontratë me "Riinvest"-in

**PRIZREN, 20 QERSHOR** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar të martën kontratë me Institutin për Hulumtime

Zhvillimore "Riinvest" për zbatimin e procedurës së vlerësimit të qeverisjeve lokale dhe certifikimit me mjedis të favorshëm biznesi

(BFC SEE).

Qëllimi i kësaj kontrate është vendosja e bashkëpunimit dhe krijimi i ambientit adekuat për bizneset në

rajonin e Evropës Juglindore përmes përbushjes së kriterëve dhe kërkesave të standardit BFC SEE - Edicioni IV.



## Mbahet takimi me fermerët e Kamenicës, diskutohen kërkesat e tyre

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

**KAMENICË, 20 QERSHOR** - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Shpend Morina, kanë pritur në takim fermerët e komunës së Kamenicës. Në këta takim janë diskutuar projektet e planifikuara për vitin 2023 nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

I pari i komunës ka thënë se bashkëpunimi me fermerë ka qenë i shkëlqyeshëm dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë ende në të mirë të fermerëve. "Më parë fermerët kanë mundur të

jenë përfitues të subvencioneve vetëm njëherë, ndërsa tani me ndryshimin e Rregullores për Subvencione mund të jenë përfitues më shumë se njëherë. Ne kemi pasur bashkëpunim shumë të mirë me ju pasi që të gjithë buxhetin e Drejtorisë së Bujqësisë e kemi destinuar në projekte të cilat i kemi bërë bashkë me ju. Çdoherë ju kemi pyetur se për çfarë ju keni nevojë sepse u kemi kushtuar rëndësi cilësisë së produkteve që u japim e jo sasisë. Subvencionet për qumësht do të vazhdojnë ende, po ashtu së shpejti do të përfundojë procesi i inventarizimit të tokave bujqësore. Pra, të gjitha po bëhen në bashkëpunim me ju", ka thënë Rahimaj.



Edhe drejtori Shpend Morina ka theksuar bashkëpunimin me fermerë për të gjitha nevojat që ata kanë. "Kemi filluar një

praktikë të re, t'i përshtatemi kërkesës dhe nevojës që kanë fermerët. Nuk kemi dashur të bëjmë projekte nga zyra pa ju

pyetur", ka thënë ai, duke përmendur projektet e realizuara gjatë vitit 2022.

Ndërsa kërkesat e fermerëve ishin të ndryshme. Ato kishin të bënin me subvencionim të farës për të gjithë fermerët, për rregullimin e një tregu të kafshëve nëse është mundësia, për matrikula, kishte kërkesa për centrifuga dhe shkrirëse dylli si dhe për farë për lule për mjaltëdhënie për bletarët. Po ashtu, disa kërkesa të tyre kishin të bënin edhe për mekanizma bujqësorë si spërkatëse, mbjellëse misri, pastaj një fabrikë të patates. Këto kërkesa janë shënuar nga zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë në mënyrë që t'i shqyrtojnë për t'i realizuar.

## Komuna e Gjilanit ka përfunduar dëgjimet publike për kornizën afatmesme buxhetore

**GJILAN, 20 QERSHOR** - Dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore në komunën e Gjilanit ishin disa takime të hapura ku banorët e fshatrave dhe lagjeve të Gjilanit diskutuan dhe shprehën nevojat e tyre. Në këto takime banorët sollën në vëmendje disa kërkesa kryesore për zhvillimin e komunës.

Kanalizimi ishte një nga kërkesat kyçe që u përmend në dëgjime. Banorët kërkonin zhvillimin e infrastrukturës së kanalizimeve për ta parandaluar ndotjen e mjedisit dhe për ta përmirësuar shëndetin publik. Ata dëshironin që ujërat e zeza të trajtoheshin dhe të largoheshin në mënyrë të sigurt dhe të pastër.

Asfaltimi i rrugëve ishte një tjetër



prioritet i diskutuar gjatë dëgjimeve publike. Banorët kërkonin investime në infrastrukturën rrugore për ta përmirësuar qasjen në shkolla, vendet e punës dhe ndërlihdjen

me rrugë të tjera. Një rrugë e asfaltuar dhe e mirëmbajtur do të ndikonte pozitivisht në qarkullimin e qytetarëve dhe në lehtësimin e kushteve të udhëtimit.

Ndriçimi ishte një tjetër aspekt që u theksua. Banorët kërkonin ndriçim të mirëfilltë në rrugët kryesore, lagjet dhe fshatrat për ta rritur sigurinë dhe komoditetin e qytetarëve. Ndriçimi i përmirësuar do të ndikonte në sigurinë publike dhe do ta lehtësonte qarkullimin në orët e vona të mbrëmjes. Investimet në shkolla ishin një kërkesë e fortë që u përmend gjatë diskutimeve. Banorët dëshironin shkolla më të mira, infrastrukturë të përdorshme, mjedis më të sigurt dhe më të pastër për t'u ofruar fëmijëve një arsimim të cilësisë së lartë. Ata kërkonin rritjen e investimeve në arsim dhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies. Përveç kërkesave të mësipërme, banorët përmendën nevojën për

investime në shtëpitë e shëndetit dhe ndërtesat e tjera shëndetësore. Ata dëshironin shërbime më të mira shëndetësore, të arrijnë me lehtësi në shtëpitë e shëndetit dhe ta marrin kujdesin dhe trajtimin e nevojshëm për shëndetin e tyre dhe të familjeve të tyre.

Këto kërkesa dhe nevoja të shprehura nga banorët do të analizohen nga autoritetet komunale dhe institucionet përgjegjëse për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit komunal. Për t'i adresuar këto kërkesa, duhet të bëhet një vlerësim i nevojave prioritare dhe të përcaktohen burimet financiare për t'i kryer investimet e nevojshme në infrastrukturë dhe shërbime publike në komunën e Gjilanit.

## Kryeqyteti nis aksionin për dërgimin e qenve endacakë në strehimore

**PRISHTINË, 20 QERSHOR** - Si vazhdim i veprimeve të shumta për trajtimin e qenve endacakë, me vendim të kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama, ka nisur aksioni për largimin e këtyre kafshëve nga rruga dhe dërgimin e tyre në strehimore të licencuar nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit, ku do të trajtohen si duhet dhe përgatiten më pas për adoptim.

Nisjen e këtij aksioni e kanë përcjellë drejtori për Siguri dhe Emergjencë, Lulzim Fushtica dhe këshilltarët

Bajram Gecaj e Pëllumb Bajčinovci. "Ky aktivitet do të vazhdojë në ditët në vazhdim. Qëllimi është që qentë të largohen nga rruga dhe të vendosen në strehimore të licencuar nga AVUK-u, ku do të trajtohen në mënyrë humane, dhe komuna do të vazhdojë t'i subvencionojë këtë strehimore për qentë që do t'i mbajë, ku do t'i përgatitim edhe për adoptim", ka thënë Fushtica. Komuna e Prishtinës, po ashtu, është duke e përgatitur rregulloren për trajtimin e qeneve endacakë, ku

përfshihet edhe mënyra se si mund të adoptohet një qen i tillë, të cilin do ta trajtojë falas në çfarëdo kohe veterinari i kryeqytetit në qendrën për trajtimin e tyre e cila gjendet në Hajvali të Prishtinës dhe do të hapet së shpejti. "Do t'i subvencionojmë edhe qytetarët që janë të interesuar të adoptojnë qentë. Një person që e merr një qen do të subvencionohet 50 euro në muaj. Qytetarët mund t'i marrin deri në pesë qenë", ka deklaruar drejtori për Siguri dhe Emergjencë, Lulzim Fushtica.



Kryeqyteti është duke ndërmarrë veprime të shumta për trajtimin e qenve

endacak, ku deri tani janë ndarë 1 milion e 300 mijë euro.

## Situata në veri, gazetari Berisha: Ekziston vetëm një Kosovë dhe jo dy

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Gazetari Ridvan Berisha ka reaguar për zhvillimet e fundit në veri. Ai ka thënë se sundimi i ligjit është standard i panegociueshëm perëndimor. E, sipas Berishës, pse tani zbatimi i ligjit në një pjesë të territorit shndërrohet në faj për Kosovën?! "NATO në Kosovë është që prej vitit 1999. Tani e kam pak të paqartë se si aleanca më e fuqishme ushtarake në botë toleron kërcënimet serbo-ruse në veri të shtetit të Kosovës. Kosova është shtet demokratik, ka

mirëkoordinuar veprimet në fushën e sigurisë me aleatët e saj, ka mbyllur sytë përpara grupeve kriminale me koston që paqja të arrihet. Ç'faj ka Kosova tani?! Asnjë gjë, për gjykimin tim. Sundimi i ligjit është standard i panegociueshëm perëndimor. Pse tani zbatimi i ligjit në një pjesë të territorit shndërrohet në faj për Kosovën?! E papranueshme!", ka shkruar Berisha në "Facebook". Berisha ka theksuar se taktizimet e molitura të tjera të

kësaj qeverie fare nuk i komenton. "Sikundër që mbeten me pikëpyetje formulimet shumëkuptimëshe të marrëveshjes së 27 shkurtit në Bruksel e po ashtu edhe dakordimi në Ohër më 18 mars për planin e zbatimit. Parasegjithash me intereson vetëm zbatimi i ligjit në çdo pjesë të shtetit! Ekziston vetëm një Kosovë dhe jo dy siç mund të hamendësoj se mund të ketë plane për ta komprometuar rendin kushtetues!", ka shkruar Ridvan Berisha.



## Hoxhaj me delegacionin nga Parlamenti i Austrisë: Procesi politik riintegron komunitetin serb dhe largon bandat nga veriu



### "Epoka e re"

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka pritur në takim delegacionin nga Parlamenti i Austrisë, i cili po qëndron në vizitë në Kosovë në kuadër të Grupit të Miqësisë Austri - Kosovë. Delegacioni nga Parlamenti i Austrisë ishte në këtë përbërje: Carmen Jeitler-Cincelli - kryetare e Grupit të Miqësisë, Andreas Minnich, Petra Wimmer, Markus Leinfellner, Nikolaus Scheraka - anëtarë, Lukas Mussi - nënkryetar

i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Parlamentin e Austrisë, Matthias Urrisk - këshilltar i kryetares së Grupit të Miqësisë.

Fillimisht nënkryetari Hoxhaj e vlerësoi shumë pozitive këtë vizitë të Grupit të Miqësisë nga Austria e cila po realizohet në kohën e duhur, kur Kosova ka nevojë për Austrinë mike.

Carmen Jeitler-Cincelli, gjithashtu, shprehu mirënjohje për programin interesant të organizuar për delegacionin ku përfshihen edhe takimet me kryeministrin dhe presidentin.

Hoxhaj falënderoi Austrinë për gjithë mbështetjen që ia ka dhënë Kosovës para dhe pas shpalljes së pavarësisë. Ai pohoi se populli i Kosovës gjatë historisë është rreshtuar në anën e duhur politikisht, por edhe u mbështet nga vende mike siç është Austria. Hoxhaj e ka falënderuar Ambasadën e Austrisë në Kosovë, e cila, sipas tij, ka punuar shumë dhe ka mbështetur shumë Kuvendin e Kosovës, por shtoi se Kosova ka nevojë për bashkëpunim më të ngushtë ekonomik, arsimor dhe kulturor me Austrinë. "Austria është ndër

vendet e BE-së që zor mund të gjendet me mbështetjen dhe përkrahjen që i ka dhënë Kosovës, prandaj nuk është rastësi që ekziston Grupi i Miqësisë Kosovë - Austri", ka deklaruar Hoxhaj. Carmen shprehu kënaqësinë që në Kosovë ka interes të madh të mësohet gjuha gjermane. Temë kryesore ishte situata në komunat veriore të Kosovës dhe si mund të stabilizohet ajo. Delegacioni austriak shprehu gatishmërinë të kontribuojë dhe ta mbështesë Kosovën në cilëndo fushë që kërkohet. Duke e bërë shtetin serb dhe

presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, përgjegjës kryesor për dhunën në veri, Hoxhaj ka kërkuar lirim të menjëhershëm të tre policëve të Kosovës. Ai ka theksuar se mbështetja e Austrisë dhe vendeve të BE-së do të ishte shumë e mirëseardhur për ta stabilizuar situatën në veri por, sipas Hoxhaj, edhe Qeveria e Kosovës duhet të bashkëpunojë me partnerët amerikanë dhe evropianë për ta shtensionuar situatën dhe përmes procesit politik në veri të vendit të riintegrohet komuniteti serb dhe largohen bandat nga veriu.

## Dita Botërore e Refugjatëve, Haradinaj: Shqiptarët më së miri e dinë ndjenjën e largimit me forcë nga atdheu

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Dita Botërore e Refugjatëve na rikujton përpjekjen e okupatorit serb

për spastrimin etnik duke deportuar me forcë miliona shqiptarë nga Kosova gjatë Luftës Çlirimtare 1998-1999, por edhe deportimin e qindra

mijëra të tjerëve anekënd botës nga zonat e luftës. "Shqiptarët më së miri e dinë ndjenjën e largimit me forcë nga atdheu. Falënderues

përjetësisht ndaj të gjithë miqve tanë kudo nëpër botë që strehuan familjet shqiptare në ditët më të vështira", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



## PSD-ja: Qeveria i përmend punëtorët vetëm për fushatë

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Partia Socialdemokrate (PSD), e drejtuar nga Dardan Molliqaj, ka reaguar për numrin e punëtorëve që po vdesin në vendin e punës. "Edhe një punëtor vdes në vendin e punës. Për arsyen e njëjtë, për shkak të mungesës elementare të kushteve në punë. Përveç i paguar keq, punëtori në Kosovë është edhe i pambrojtur. Kështu, çdo ditë

pune, për secilin punëtor mund të jetë dita e fundit e jetës së tij", është thënë në njoftimin e PSD-së. Sipas kësaj partie, ky është shteti i mirëqenies që e propagandon kryeministri Kurti. "Ky fenomen shqetësues është fytyra e vërtetë e kujdesit të shtetit ndaj shtresës punëtore. Qeveria i përmend punëtorët vetëm për fushatë, në pushtet i harron duke i lënë

nën mëshirën e punëdhënësit. Në vend se të zgjerohet kujdesi i qeverisë edhe në sektorin privat, kjo qeveri u ka shpallur luftë edhe atyre që janë nën kujdesin shtetëror duke i luftuar sindikatat. Edhe sa të tjerë do të vdesin? Edhe sa kohë qeveria do të jetë e shurdhër karshi pabarazisë dhe keqtrajtit të punëtorëve në sektorin privat?", është theksuar në njoftimin e PSD-së.



## BQK-ja mbështet agjendën e gjelbër në sektorin financiar

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Ushtruesi i detyrës së zëvendësguvernatorit për mbikëqyrje financiare, Nexhat Kryeziu, ka marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës për promovimin e Financimit të Qëndrueshëm dhe Standardeve Ambientale, Sociale dhe Qeverisëse. Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve financiare që rrjedhin nga ndryshimet klimatike dhe mjedisore është një nga sfidat me të cilat po përballen autoritetet mbikëqyrëse dhe rregullative, përfshirë edhe sektorin financiar. "Fakti që jemi mbledhur këtu për të diskutuar për sfidat e ndryshimeve klimatike dhe mjedisore së bashku; rregullatorë, banka dhe organizata ndërkombëtare (siç është IFC), tregon se ky aspekt aktualisht është një nga çështjet urgjente dhe më të diskutuara në nivel të politikëbërjes në aspektin global. Siç edhe e dini, si pjesë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, Kosova ka miratuar Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor në

Samitin e Sofjes, në nëntor 2020, e cila është një udhërrëfyes gjithëpërfshirës strategjik lidhur me ndryshimet klimatike. Kjo agjendë tregon rrugën drejt zgjidhjeve të reja të energjisë, që nënkupton rritjen e investimeve në burime të ripërtërishme, si dhe zhvillim të qëndrueshëm mjedisor", ka thënë zëvendësguvernatori Kryeziu.

Ai ka shtuar se sektori bankar paraqet komponentin kryesor të sistemit financiar të Kosovës, ku ndikimi i tij në ekonominë e Kosovës është shumë domethënës. Si pjesë e angazhimit të BQK-së për t'i integruar rreziqet klimatike dhe mjedisore në praktikën mbikëqyrëse, në bashkëpunim me Bankën Botërore është duke u hartuar një strategji, e cila do të finalizohet gjatë këtij viti, ku do të definohen rekomandimet dhe kërkesat mbikëqyrëse për menaxhimin e rreziqeve të lidhura me ndryshimet klimatike dhe mjedisore. Elementet kryesore të Strategjisë 2024-2026 përfshijnë veprimet si: Përgatitja e një table të gjelbër, ku do të vlerësohen indikatorët e ekonomisë së gjelbër në ekonominë e Kosovës dhe në sistemin financiar; Nxjerrja e standardeve, ku do të



përkruhen parimet që sektori bankar do të duhet t'i implementojë gjatë identifikimit, menaxhimit, kontrollit dhe raportimit të rreziqeve klimatike; Definimi i kornizës së raportimit lidhur me raportimin e ekspozimit të bankave ndaj rreziqeve klimatike dhe mjedisore; Implementimi i stres testit makroprudencial për rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe përgatitja e metodologjisë për vlerësimin e rreziqeve klimatike dhe integrimi i plotë i tyre në aktivitetet

mbikëqyrëse të BQK-së. "Gjithashtu, ne tashmë kemi aplikuar për t'u anëtarësuar në Rrjetin për Gjelbërimin e Sistemit Financiar, i cili është një rrjet prej 121 bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse financiare prestigjioze, që synon ta përshpejtojë rritjen e financimit të gjelbër dhe të zhvillojë rekomandime për rolin e bankave qendrore për ndryshimet klimatike. Shpresojmë që së shpejti të bëhemi pjesë e këtij rrjeti prestigjioz të bankave

qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse financiare. Mbikëqyrja dhe menaxhimi i rreziqeve klimatike dhe mjedisore paraqet një udhëtim të gjatë drejt një teme të re dhe komplekse për të gjithë ne. Mirëpo, duke u angazhuar dhe punuar së bashku, do t'i tejkalojmë këto sfida më lehtë dhe trajtojmë ndryshimet klimatike dhe mjedisore në kohë", ka thënë zëvendësguvernatori Kryeziu, duke premtuar se BQK-ja do të jetë partnere për realizimin e këtij tranzicioni.

## ATK-ja vazhdon monitorimin e bizneseve për arka fiskale

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Verifikimi i bizneseve, nëse janë duke respektuar thirrjet ligjore për lëshim të kuponit fiskal, ka vazhduar edhe ditët e fundit në qytetin e Prizrenit, ku Administrata Tatimore e Kosovës u fokusua te tatimpaguesit të cilët nuk janë të pajisur me pajisje elektronike fiskale (PEF) nuk lëshojnë kuponë fiskalë dhe ata tatimpagues që lëshojnë kuponë jofiskal. Po ashtu, veç kësaj janë monitoruar edhe punëtorët nëse janë të

regjistruar. Si rezultat i këtyre aktiviteve në terren/qyteti Prizrenit janë vizituar pesë subjekte biznesore, tek të cilat është konstatuar se nuk kanë lëshuar kupon fiskal pas shërbimeve të ofruara. Gjithsej janë lëshuar 91 gjoba në vlerë 35 125 mijë euro, si dhe do të iniciohet rast penal. Këto aktivite kanë evidentuar edhe 26 punëtorë të paregjistruar. Administrata Tatimore e Kosovës ua rikujton të gjithë

personave të cilët merren me aktivite afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor, aty ku nuk kërkohet të lëshohet faturë tatimore, janë të obliguar të pajisen me pajisje elektronike fiskale (PEF)/sistem fiskal (SF) dhe të lëshojnë kupon fiskal. Disa nga veprimtaritë si: tregti, prodhim, shërbim, shëndetësi, hoteleri, arsim, transport, artistike-zbavitëse etj. nuk zbatojnë këtë obligim, prandaj ATK-ja u ka bërë thirrje të pajisen me PEF/SF dhe të lëshojnë kupon fiskal.





# Cila është axhenda politike e Inteligjencës Artificiale?



Nga Santiago ZABALA & Claudio GALLO

“Mulliri i dorës të jep mundësinë të kesh shoqëri me feudalizmin; ndërsa mullirit i madh me avull të shoqëroresh me kapitalistin industrial”- thoshte dikur Karl Marksi. Dhe ai kishte të drejtë. Ne kemi parë vazhdimisht gjatë historisë, se si shpikjet teknologjike përcaktojnë mënyrën dominuese të prodhimit, dhe bashkë me të llojin e autoritetit politik të pranishëm në një shoqëri.

Atëherë çfarë do të na sjellë Inteligjenca Artificiale (AI)? Kush do të përfitojë nga kjo teknologji e re, e cila jo vetëm që po bëhet një forcë prodhuese mbizotëruese në shoqëritë tona (ashtu si dikur mulliri i dorës dhe mulliri me avull), por siç po vazhdojmë të lexojmë në lajme, duket edhe se po “i shpëton shumë shpejt kontrollit tonë?”.

A do të mundet Inteligjenca Artificiale të ketë një jetë të pavarur, siç duket se besojnë shumë njerëz, dhe të diktojë e vetme rrjedhën e historisë tonë? Apo do të përfundojë si shpikja teknologjike e radhës, e cila i shërben një axhende të caktuar, dhe nga e cila përfiton një nëngrup i caktuar njerëzish?

Kohët e fundit, shembuj të përmbajtjeve hiperrealiste, të krijuara nga AI, si një “intervistë” me ish-kampionin e botës në Formula 1, Majkell Shumaker, që nuk është në gjendje të flasë me median që pas aksidenti të rëndë duke skijuar në vitin 2013; “fotografite” që tregojnë ish-presidentin Donald Trump duke u arrestuar në Nju Jork; apo esetë studentore në dukje autentike “të shkruara” nga chatboti i famshëm i OpenAI, ChatGPT, kanë ngritur shqetësime serioze midis

intelektualëve, politikanëve dhe akademikëve në lidhje me rreziqet që mund të sjellë për shoqëritë tona kjo teknologji e re.

Shqetësime të tilla nxitën bashkëthemeluesin e kompanisë Apple, Stiv Vozniak, figurën e njohur të Inteligjencës Artificiale, Joshua Bengio dhe bosin e Tesla/Twitter, Elon Mask, mes shumë të tjerëve, që të nënshkruanin në mars një letër të hapur ku akuzonin laboratorët e AI se ishin “të përfshira në një garë të dalë jashtë kontrollit për të zhvilluar dhe vënë në përdorim mendje dixhitale gjithnjë e më të fuqishme që askush – madje as krijuesit e tyre – nuk mund t’i kuptojnë, parashikojnë apo kontrollojnë me besueshmëri”, dhe u bënë thirrje zhvilluesve të AI që të ndalin punën e tyre.

Kohët e fundit, Xhefri Hinton – i njohur si një nga tre “kumbarët e AI” dha dorëheqjen nga Google “për të folur lirshëm mbi rreziqet e Inteligjencës Artificiale” ku ndër të tjera tha se i vjen pjesërisht keq për kontributet e tij në këtë fushë. Ne e pranojmë që AI – si çdo teknologji që përcaktojnë epokën kur shfaqet – vjen me anë negative dhe me rreziqe të konsiderueshme. Por në dallim nga Vozniak, Bengio, Hinton dhe të tjerët, ne nuk besojmë se ajo mund të përcaktojë vetë rrjedhën e historisë, nëse nuk ka asnjë kontribut ose udhëzim nga njeriu.

Ne nuk i ndajmë shqetësime të tilla, sepse e dimë se, ashtu siç ndodh me të gjitha pajisjet dhe sistemet tona të tjera teknologjike, se axhendat tona politike, sociale dhe kulturore janë gjithashtu të integruara në teknologjitë e AI.

Siç shpjegoi me të drejtë filozofja Dona Harauej: “Teknologjia nuk është neutrale. Ne jemi brenda asaj që bëjmë, dhe ajo është brenda nesh”. Përpara se të

shpjegojmë më tej pse nuk kemi frikë nga një i ashtuquajtur marrja e AI, duhet të përcaktojmë dhe shpjegojmë se çfarë është në të vërtetë Inteligjenca Artificiale.

Ky është një mision shumë sfidues, jo vetëm për shkak të kompleksitetit të produktit në fjalë, por edhe për shkak të mitit që është krijuar mbi AI nga media. Ajo që po i komunikohet me këmbëngulje sot publikut, është se makina e ndërgjegjshme është thuarje këtu, dhe se shumë shpejt jeta jonë e përditshme do të ngjajë me ato të përshkruara në filma si “2001: A Space Odyssey”, “Blade Runner” dhe “The Matrix”.

Por kjo është një narrativë e rreme. Ndërsa nuk ka dyshim se po ndërtojmë kompjuterë dhe makineri llogaritëse gjithnjë e më të afta, nuk ka asnjë tregues që kemi krijuar apo jemi afër krijimit të një mendje dixhitale që mund të “mendojë”.

Noam Çomski argumentoi kohët e fundit në një artikull të “New York Times” se “ne e dimë nga shkenca e gjuhësisë dhe filozofia e njohurive se programet e të mësuarit përmes makinerive si ChatGPT, ndryshojnë thellësisht nga mënyra se si njerëzit arsyetojnë dhe përdorin gjuhën”.

Duke imituar filozofin gjerman Martin Haideger mund të themi shkurtimisht: “Inteligjenca Artificiale nuk mendon por vetëm llogarit”. Federiko Fagin, shpikësi i mikroprocesorit të parë komercial, mitikut Intel 4004, e shpjegoi këtë gjë shumë qartë në librin e tij të vitit 2022 “Irriducibile” (I pandërprerë): “Ekziston një dallim i qartë midis ‘njohurisë’ së makinës simbolike ... dhe njohurive semantike njerëzore. I pari është informacion objektivin që mund të kopjohet dhe ndahet. Ndërsa i dyti një përvojë subjektive dhe private që ndodh në

intimitetin e qenies së vetëdijshme”.

Atëherë çfarë do të thotë e gjithë kjo për të ardhmen tonë? Nëse AI nuk mund të “mendojë”, kush do të përfitojë nga kjo dhe cili do t’i japë autoritet politik? Mbi çfarë vlerash do të mbështeten vendimet e saj? Çomski dhe kolegët e tij i bënë një pyetje të ngjashme për ChatGPT. “Si një inteligjencë artificiale, unë nuk kam bindje morale apo aftësi për të bërë gjykime morale, ndaj nuk mund të konsiderohem imoral apo moral. Mungesa ime e besimeve morale është thjesht rezultat i natyrës sime si një model i mësimit të makinës” - u tha atyre chatbot.

Ku e kemi dëgjuar më parë këtë kasje? A nuk është jashtëzakonisht e ngjashme me vizionin etikisht neutral të liberalizmit ekstrem? Liberalizmi aspiron të kufizojë në sferën individuale private të gjitha vlerat fetare, civile dhe politike që rezultuan kaq të rrezikshme dhe shkatërruese në shekujt XVI-XVII. Ai dëshiron që të gjitha aspektet e shoqërisë të rregullohen nga një formë e veçantë – dhe në një farë mënyre misterioze – e nacionalitetit: tregu. Inteligjenca Artificiale duket se po promovon të njëjtën markë të racionalitetit misterioz.

E vërteta është se ajo po shfaqet si inovacioni i ardhshëm global i “biznesit të madh” që do të vjedhë punë nga njerëzit – duke i bërë të tepërt punëtorët, mjekët, avokatët, gazetarët dhe shumë të tjerë. Vlerat morale të robotëve të rinj janë identike me ato të tregut. Tani është e vështirë të imagjinohen të gjitha zhvillimet e mundshme, por në horizont po shfaqet një skenar i frikshëm.

Dejvid Kruger, asistent profesor në mësimin e makinerive në Universitetin e Kembrixhit,

komentoi së fundmi në “NewScientist”: “Në thelb çdo studiuues i AI (përfshirë veten time) ka marrë fonde nga teknologjia e madhe. Në një moment, shoqëria mund të ndalojë së besuari tek garancitë që hapin njerëzit me konflikte kaq të forta interesi, dhe të arrijë në përfundimin, siç kam bërë unë, se neglizhimi i paralajmërimeve mbi AI tradhton mendimin e dëshiruar dhe jo kundër-argumentet e mira”.

Në rast se shoqëria i kundërvihet Inteligjencës Artificiale dhe promotorëve të saj, ajo mund të dëshmojë se Marksi e ka gabim, dhe ta parandalojë zhvillimin kryesor teknologjik të epokës aktuale që të përcaktojë se kush e mban autoritetin politik. Por tani për tani, AI duket se është këtu për të qëndruar.


Dhe axhenda e saj politike është plotësisht e sinkronizuar me atë të kapitalizmit të tregut të lirë, qëllimi kryesor (dhe i padeklaruar) i të cilit është të fragmentojë çdo formë solidariteti shoqëror dhe komunitar. Rreziku i AI nuk është se është një inteligjencë dixhitale e pamundur për t’u kontrolluar, dhe që mund të shkatërrojë ndjenjën tonë për veten dhe të vërtetën përmes imazheve, eseve, lajmeve dhe historive “të rreme” që gjeneron.

Rreziku është se kjo shpikje monumentale, duket se po i bazon të gjitha vendimet dhe veprimet e saj mbi të njëjtat vlera shkatërruese dhe të rrezikshme që drejtojnë kapitalizmin grabitqar.

*Shënim: Santiago Zabala, profesor i filozofisë i kërkimit ICREA në Universitetin Pompeu Fabra në Barcelonë. Claudio Gallo, ish-redaktor i gazetës italiane “La Stampa” dhe korrespondent i saj në Londër.*

“Al Jazeera” – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Zhdrella emërohet drejtor sportiv i Llapit

**PODUJEVË, 20 QERSHOR** - Ish-mesfushori i spikatur Mentor Zhdrella është emëruar drejtor sportiv i skuadrës së Llapit. “Bordi drejtues i klubit ka vendosur për Zhdrellën në pozitën e drejtorit sportiv pasi që kontributi i tij për Llapin në

të kaluarën si futbollist ka qenë i jashtëzakonshëm. 34-vjeçari është paraqitur sot në prani të kryetrajnerit Tahir Batatina, i cili i ka dëshiruar mirëseardhje Zhdrellës në mesin tonë”, thuhet në njoftimin e Llapit. Ndërsa Zhdrella është

shprehur i kënaqur me emërimin e tij në pozitën e drejtorit sportiv. Ai ka premtuar se do të angazhohet fuqishëm që klubi t’i arrijë objektivat. “Falënderoj bordin drejtues të klubit, presidentin e klubit Beqir Batatina për besimin!

Jam jashtëzakonisht i lumtur për emërimin tim në këtë pozitë kaq të rëndësishme. Kemi shumë punë për të bërë dhe me organizimin që ka bërë klubi besoj do t’ia dalim t’i arrijmë objektivat tona”, ka deklaruar Zhdrella.



## Adieu Alain Giresse

Federata e Futbollit e Kosovës, një ditë pas humbjes së “dardanëve” nga Bjellorusia (2-1) në kualifikueset e Kampionatit Evropian, e ka shkarkuar trajnerin francez Alain Giresse. Ky i fundit e ka drejtuar Kosovën në 11 ndeshje, ka regjistruar tri fitore, katër humbje dhe katër barazime

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 20 QERSHOR** - Alain Giresse nuk është më trajner i Përfaqësueses së Kosovës në futboll. Lajmin e ka dhënë Federata e Futbollit e Kosovës, e cila mori vendim për shkarkimin e strategut francez pas mbledhjes që kishte të martën. Barazimi ndaj Rumanisë në stadiumin “Fadil Vokrri” të premtën dhe humbja nga Bjellorusia të hënën në Hungari ishin vendimtare që

drejtesit e FFK-së të marrin vendim për ta ndërprerë bashkëpunimin me Giresin. Ky i fundit nuk dëshoi të flasë për medie pas përfundimit të mbledhjes dhe doli nga FFK-ja në shoqërinë e menaxherit të Përfaqësueses së Kosovës, Bajram Shala. “Federata e Futbollit e Kosovës njofton se në marrëveshje të dyanshme me përzgjedhësin Alain Giresse, është vendosur për ndërprerjen e bashkëpunimit. Deri te ky vendim vjen pas humbjes në ndeshjen e fundit kundër



Bjellorusisë (1-2). Federata e Futbollit e Kosovës e falënderon trajnerin Giresse për angazhimin dhe punën e tij gjatë periudhës sa ishte në krye të Përfaqësueses së Kosovës. Në të ardhmen priten reforma të mëtejshme në ekipin kombëtar”, thuhet në njoftimin

e FFK-së. Giresse e mori drejtimin e Kosovës në muajin shkurt të vitit të kaluar, derisa i ka drejtuar “dardanët” në 11 ndeshje, ku ka regjistruar tri fitore, katër humbje dhe katër barazime. Pas shkarkimit të përzgjedhësit Giresse ka reaguar edhe kryetari

i tifozëve “Dardanët”, Lulzim Berisha, i cili e vlerësoi të drejtë shkarkimin e trajnerit nga FFK-ja. “Përfaqësuesja nuk është klub. Fanella e saj dërsitet, por edhe ndihet. Është krenari ta mbash atë, jo obligim sa për t’u grumbulluar. FFK-ja veprimi drejt me shkarkimin e Gireses, por nuk duhet harruar: tifozët duan angazhim me zemër, jo formal. Ata duan sukses. Prandaj edhe e mbështetin e i mbështetin futbollistët. Siç kanë bërë ashtu edhe do të bëjnë, veçse duhet reciprocitet: lojtarët t’ua kthejnë tifozëve me angazhim! Veç kësaj, në ditët në vijim do të kemi takim bashkëpunimi me FFK-në, për t’u koordinuar për të mirën e Kosovës. Kosova përjetë dhe asnjëherë vetëm”, ka shkruar Berisha në “Facebook”.

## Klubet e Kosovës i mësojnë kundërshtarët në garat evropiane

Ballkani e ka mësuar kundërshtarin në Ligën e Kampionëve, kampionin e Bullgarisë, Ludogorets. Në Ligën e Konferencës, Gjilani dhe Dukagjini, që përfaqësojnë Kosovën, do të përballen me FC Progres Niederkorn, përkatësisht Europa FC. Ndërsa Drita e mëson sot kundërshtarin në Ligën e Evropës

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 20 QERSHOR** - Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Ballkani, e ka mësuar emrin e kundërshtarit të parë në Ligën e Kampionëve. Klubi nga Suhareka do të ketë punë me ekipin e njohur bullgar, PFC Ludogorets Razgrad. Kjo përballje që është e rrethit të

parë kualifikuese zhvillohet më 11/12 korrik, derisa ndeshja kthyesë zhvillohet më 18/19 korrik. Kundërshtari i Ballkanit ka nisur shkëlqimin që nga edicioni 2011/2012, kur u inkuadrua në elitën e futbollit bullgar, dhe që në atë sezon fitoi dy trofetë kryesorë të këtij shteti, Ligën dhe Kupën. Ludogorets ka dominuar totalisht në Bullgari në 12 vjetët e fundit, duke u



shpallur kampion çdo sezon që, në fakt, është edhe vetë historia e këtij klubi, me 12 tituj të fituar. Nga ana tjetër, tri herë ka triumfuar edhe në Kupën shtetërore. “Me këtë skuadër nuk jemi takuar asnjëherë, sikur që nuk është përballur me të asnjë ekip shqiptar. Oponenti ynë ka qenë dy herë pjesëmarrës i fazës së grupeve në Ligën e Kampionëve, ndërkaq të

arriturën më të lartë e ka shënuar në edicionin 2013/14 të Evropa Ligës, ku arriti deri në mesin e 16 skuadrave më të mira. Sezonin e kaluar Ludogoretsi luajti në grupet e Evropa Ligës, derisa pas aventurës aty, u eliminua nga Anderlecht në UECL. Na priftë e mbara!”, thuhet në njoftimin e Ballkanit. Gjilani dhe Dukagjini i Klinës do ta përfaqësojnë futbollin e Kosovës në Ligën e

Konferencës. Këto dy skuadra kanë mësuar të martën kundërshtarët në këtë rang garash. Gjilani do ta ketë përballë skuadrën nga Luksemburgu, FC Progres Niederkorn dhe lojën e parë do ta zhvillojë në udhëtim. Në anën tjetër, Dukagjini debutojnë në garat ndërkombëtare në përballje me skuadrën nga Gjibraltari, Europa FC. Skuadra nga Klina është vendase në ndeshjen e parë. Ndeshjet e para të kësaj faze do të luhen më 13 korrik, ndërsa ato të kthimit më 20 korrik. Ndërsa skuadra nënkampione, Drita, e mëson sot (e mërkurë) kundërshtarin në Ligën e Evropës.

## Atmosferë pune te Përfaqësuesja U19 në hendboll

**PRISHTINË, 20 QERSHOR** - Me atmosferë pozitive ka nisur grumbullimi i hendbollistëve të Përfaqësueses U19 të Kosovës. Hendbollistet “dardane” të reja janë mbledhur në Gjakovë, ndërsa përkushtimi është maksimal për t’u përgatitur sa

më mirë për Kampionatin Evropian që mbahet në Prishtinë. Edhe te shtabi teknik janë të vendosur që grumbullimi të shfrytëzohet maksimalisht për ta rritur nivelin e lojtareve tona. Fakti që Evropiani zhvillohet në Kosovë, shërben si motivim, por

edhe si përgjegjësi për paraqitje sa më të denjë. Fillimisht fokusi është te përgatitja fizike, ndërsa pos kryetrajnerit Granit Sahiti dhe trajneres Fatmire Basholli me lojtaret tona po punon edhe trajneri kondicional, Enver Tahiri.

Evropiani i Divizionit B mbahet prej 8 deri më 16 korrik në Prishtinë. Kosova U19 është në Grupin A së bashku me Sllovakinë, Italinë, Finlandën dhe Britaninë e Madhe. Ndeshja e parë Sllovakia - Kosovë është më 8 korrik nga ora 19:30.



## Lakersat synojnë transferimin e Chris Paul

LOS ANXHELOS, 20 QERSHOR -

Skuadra e Los Anxhelos Lakers ka nisur nga puna për ndërtimin e një ekipi kompetitiv për sezonin e ri. Më 1 korrik çelet merkato dhe skuadra kaliforniane, që sezonin e fundit shkoi deri në finalen e Konferencës së Perëndimit, synon që të rikthehet të duelojë për

titullin. Sipas "The Athletic", problemi më i madh për lakersat mbetet organizatori dhe skuadra e lakersve ka hedhur sytë kah veterani Chris Paul. Gjithçka do të varet nga dëshira e 38-vjeçarit, që aktualisht luan me Phoenixin, por nga 1 korriku ai mund të jetë lojtar i lirë dhe të ndërrojë fanellë.

Lakersat janë gati t'i ofrojnë një kontratë me minimumin e pagës që ofron Liga, duke i dhënë mundësi që të mbajnë edhe Austin Reavez dhe Rui Hachimura, pa prekur tavanin e pagesave. Problem për lakersat janë edhe dy emra të tjerë aktualisht në skuadër. Bëhet fjalë

për D'Angelo Russell dhe Dennis Schroder që, gjithashtu, duan një vend si titullar dhe më shumë minuta lojë. Ata kanë luajtur në rotacion, ndërkohë që dy emrat e paprekshëm në formacionin bazë janë LeBron James dhe Anthony Davis, që duan një person që ta organizojë lojën.



## Inzaghi: E lashë futbollin për shkak të Allegrit

MILANO, 20 QERSHOR - Filippo Inzaghi ka shkruar në librin e tij se është tërhequr nga futbollin prej trajnerit Allegri në vitin 2012. "Gazzetta dello Sport" ka publikuar disa pjesë të librit të ardhshëm të Inzaghit, që titullohet "Momenti i duhur", ku ndërfutet Massimiliano Allegri, i cili nuk e konsideronte më atë pjesë integrale të grupit të Milanit. Pra, trajneri aktual bardhezi e shtyu "gjahtarit e golave" drejt lamtumirës, para se ta kishte menduar vetë. Inzaghi gjeti marrëveshje me Gallianin për të vazhduar edhe një sezon me fanellën e Milanit, por ndërhyrja e Allegrit ishte vendimtare për fundin e karrierës së tij. "Ishte Allegri ai që e përfundoi karrierën time si lojtar. Milani dhe unë, në fakt, në pranverën e vitit 2012 kishim arritur një marrëveshje për ta vazhduar kontratën me një vit tjetër. Kisha qenë një lidhje e rëndësishme në dhomat e zhvishjes kuqezi, e cila në pak kohë kishte humbur Maldinin, Pirlon, Nestën, Gattuson, Seedorfin. Elementë të rëndësishëm që kishin lënë një boshllëk të madh. Nuk do të kisha pasur asnjë pretendim... Galliani ishte i lumtur që e kishte gjetur këtë zgjidhje së bashku me mua. Allegri e hodhi poshtë. Ai nuk më donte më në dhomat e zhvishjes dhe i tha drejtorit që të mos më rinovohej kontrata. Për



mua ishte një goditje e fortë", shkruan Inzaghi në librin e tij. Jeta e re, duke mos përfshirë më adrenalinën e topit, krijoi një keqardhje të thellë tek Inzaghi. "Në vjeshtën e vitit 2015 për herë të parë topi u shfry. Ai nuk kërcente më. Nuk isha më në gjendje ta thithja distancën nga bota ime, nga aroma e barit, nga shenjtëria e dhomës së zhvishjes. Zgjohesha në mëngjes dhe nuk dija si të arrija deri në mbrëmje. Shkova në palestër, por pa entuziazëm, vetëm për ta kaluar kohën. Më pushtoi mërzia dhe dëshpërimi. Trupi im më dërgonte sinjale pa ekuivokë për paratë. U tremba. Me të vërtetë e them qartë dhe pa turp: u frikësova, kisha bërë katër gastroskopi dhe analiza të tjera të pakëndshme. Udhëtoja

gjithnjë me një qese të mbushur me CD ekografish dhe MRI, qa ua tregoja specialistëve të ndryshëm. Kisha frikë se vuaja nga diçka serioze, madje edhe ALS". Me ndihmën e familjes, ish-sulmuesi i kuqezinjve i është rikthyer jetës normale: "Kanë qenë muaj vështirësish dhe vuajtjesh, në të cilët kam luftuar për të gjetur një rrugëdalje. Dikush e quan të jetuarit keq, dikush në një mënyrë tjetër. Preferova të dribloja përkufizimet dhe diagnozat e ndryshme dhe të përballesha me realitetin. Kuptova se cili ishte problemi dhe e kapërceva pak nga pak, duke e rrethuar veten me dashurinë e familjes. Prindërit e mi ishin të jashtëzakonshëm, e kuptonin atë që kisha nevojë".

## Leclerc: Gara në Kanada na e riktheu buzëqeshjen

MONTREAL, 20 QERSHOR - Ferrari u klasifikua në vendet 4-5 në garën e fundit të Formulës 1 të zhvilluar në pistën e Montrealit (Kanada), një rezultat pozitiv duke parë problemet që ka pasur "kokëkuqja" këtë sezon. I kënaqur nga rezultati dhe makina ka qenë Charles Leclerc. "Ndjesia pas kësaj gare është pozitive. Fundjava e kaluar ishte e mirë nga fillimi në fund. Më vjen keq për rezultatin në provat zyrtare, por gara na dha një mundësi që e shfrytëzuam. U nisëm nga vendet 10-11 dhe u renditëm në vendet 4-5 falë një strategjie të mirë dhe një ritmi të kënaqshëm", u shpreh më tej piloti monogask i Ferrarit. "Objektivi është ta përmirësojmë makinën



dhe mendoj se kemi gjetur diçka pozitive, pasi u ndjeva mjaft komod në makinë garën e fundit. Gjithsesi, duhen bërë të tjerë hapa përpara. Makina që pilotova në Kanada është më e mira e këtij sezoni dhe kjo më jep kurajë", ka deklaruar Leclerc. "Jemi larguar

nga Kanadaja me një buzëqeshje të lehtë, por ajo e madhe do të vijë kur të dublojmë për fitoren. Ndaj, nga sot rikthehem të punojmë për ta shkurtuar dallimin që kemi me Red Bullin dhe makinat e tjera para nesh", u shpreh Charles Leclerc.

### SHKURT

#### Ish-futbollisti i Prishtinës, Gledi Mici, paraqitet te Tirana

Skuadra e Tiranës ka arritur të nënshkruajë me Gledi Micin, mbrojtësin që në të kaluarën ka qenë pjesë e kombëtares shqiptare. 32-vjeçari do ta vazhdojë karrierën te klubi bardheblu pas një aventure trevjeçare me skuadrën e Prishtinës, me të cilën i përfundoi kontrata. Ai ka qenë edhe pjesë e skuadrave të Apolonisë, Kamzës, Flamuritit, Kukësit dhe Skënderbeut. Ai i ka fituar të gjithë trofetë e mundshëm në Kosovë, ndërsa kampion është shpallur edhe në Shqipëri me Skënderbeun e Kukësin, por edhe me Shkëndijën e Tetovës në Maqedoninë e Veriut.

#### Nkunku, lojtar i ri i Chelseat

Tashmë nuk ka më dyshime, sulmuesi francez Christopher Nkunku është lojtar i Chelseat. Këtë lajm e ka dhënë klubi anglez në rrjetet sociale. "Bomberi" francez kishte një klauzolë lirim prej 60 milionë eurosh e cila u pagua nga Chelsea për ta bërë të mundur këtë transferim. Kontrata e ish-lojtarit të Leipzigut dhe PSG-së me klubin anglez të Chelseas do të jetë deri në qershor të vitit 2029.

#### Dzeko, afër Fenerbahçes

Skuadra e Fenerbahçes është duke punuar në detajet e fundit për ta kompletuar transferimin e Edin Dzeko Brenda javës, shkruan gazetari Fabrizio Romano. Sulmuesi boshnjak do t'i bashkohet ekipit nga Turqia me zero shpenzim, pasi i përfundon kontrata me Interin në këtë muaj. 37-vjeçari këtë sezon me italianët ka regjistruar 52 paraqitje në të gjitha garat, duke realizuar 14 gola dhe 5 asistime.

#### Garcia: Kam ardhur për të fituar trofe

Epoka e Rudi Garcia fillon në Napoli. Pas fitores së Serisë A dhe lamtumirës së Luciano Spalletti, trajneri i ri i Napolit është paraqitur para medieve dhe tifozëve duke treguar menjëherë synimet e tij. "Kur filloj një kompeticion, luaj gjithmonë për ta fituar. Jam këtu për të fituar trofe. Ne ramë menjëherë dakord me presidentin për ambiciet. Jam i sigurt se ai do të më japë një ekip cilësor. Nuk do të bëj ndryshime taktike, por dua të vendos vullën time në lojë. Dhurata e parë e presidentit? E ka bërë tashmë duke më sjellë këtu. Dua t'i përshëndes tifozët për pritjen e tyre dhe ta përgëzoj presidentin dhe ekipin e tij, i cili së shpejti do të jetë i imi, për atë që bënë sezonin e kaluar. Synimi im është ta forcoj lidhjen me ekipin tim dhe të fitoj sa më shumë", ka thënë Garcia. "Rikthimi në Serinë A? Shpresoj të jem një Garcia me më shumë përvojë sepse kam bërë shumë. Është një kënaqësi e vërtetë të rikthehem në Itali dhe në Napoli. Mezi pres ta zbuloj qytetin. Do të përpiqem ta jap maksimumin që di të bëj dhe ta bëj pikërisht këtu te Napoli", ka shtuar Garcia.

## Guardiola: Fitova Ligën e Kampionëve, sepse Lukaku nuk shënoi nga tri metra


Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, i është përgjigjur një pyetjeje se si ekipi i tij e fitoi Ligën e Kampionëve sezonin e

kaluar. "Kemi kaluar tetë vjet për ta fituar Ligën e Kampionëve. E fitova këtë turne sepse Romelu Lukaku nuk mundi të shënonte

kundër nesh nga tri metra", citon Guardiolen "Football". Kujtojmë se në finalen e Ligës së Kampionëve 2022-2023, Manchester City mposhti

Interin me rezultat minimal 1-0. Vlen të theksohet se "qytetarët" për herë të parë në historinë e tyre u bënë pronarë të këtij trofeu, por

për trajnerin spanjoll kjo është fitorja e tretë në turneun më prestigjioz evropian, pasi ka fituar dy me Barcelonën.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



## Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- Argur Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së 10 të sh.m.l. "Dr. Xheladin Deda".

- Kreshnik Simoni Pjetrshon KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Anton Çeta" nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Kreshnik Simoni Pjetrshon KK Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Saranda Marashi nga Ramoci KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Luigj Gurakuqi" Korenic KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Lulzim Avdiu, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani"

- Vehbi Ahmeti, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda"

- Fitore Xhemajli, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Fazli Grajqevci"

- Hysen Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Artiola Batusha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Florjan Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl, 10 të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".

- Nahit Shala nga Rogova e Gjakovës shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Virxhina Barbullushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

- Muhamet Zherka shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizreni.

- Leon Kuqanaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFCI".

- Albana Peci shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 te shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi –Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Enver Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIIIshfmu "Fadil Hisari" Prizren.

- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme "ARKITEKT SINANI".

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "FRANG BARDHI".

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Flamur Godeni nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

